



Rektorati

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

Nr. 71 Prot.

Tiranë, më 21.01.2022

URDHËR

Nr. 8, Datë 21.01.2022

MBI

**DISA MASA PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE
ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në nenin 13 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhërin nr. 8, datë 14.01.2020 të MASR “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 19 datë 19.02.2020, duke qenë se ndodhemi në kushtet e vakancës për një anëtar të Senatit Akademik nga rradhët e studentëve pas dorëheqjes së studentes anëtare znj. Dea Shubleka, një anëtar të Komisionit të Etikës pas largimit të anëtarit z. Altin Basha në një detyrë jashtë UART si dhe nevojës për zgjedhjen e Drejtuesëve të Njesisë Bazë “Aktrim dhe Teori Arti” në FAS dhe Njesisë Bazë “Arte të Aplikuara” në FAB

URDHËROJ

1. Fillimin e procesit zgjedhor për pozicionet lartpërmendur në datën **09.03.2022**.
2. Data e zhvillimit të këtyre zgjedhjeve është data **07.04.2022**.
3. Senati Akademik, brenda datës 04.02.2022, zgjedh me votim të fshehtë anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) me përfaqësues nga cdo fakultet dhe studentët. Senati cakton edhe sekretarin e KIZ i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë KIZ. Dekanët e fakulteteve, brenda afateve të përcaktuara, të organizojnë punën në zbatim të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”.





4. Në zbatim të nenit 11 *Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve të rregullores* “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik ne Universitetin e Arteve”, DMBNj pranë rektoratit të UART në bashkëpunim me njesitë bazë të fakulteteve të hartojnë listat e zgjedhjeve për personelin akademik të punësuar me kohë të plotë brenda datës 07.03.2022. Sekretaritetë mësimore pranë fakulteteve të hartojnë listën e zgjedhësve për studentët brenda datës 07.03.2022.
5. Emrat kandidatë për anëtar të KIZ që do të zgjidhen nga Senati Akademik nuk duhet të jenë nga anëtarët e personelit akademik ose rradhët e studentëve që do të vetëkandidohen për tu zgjedhur në autoritetet ose organet drejtuese të UART për të cilat po organizohet ky proces zgjedhor.
6. Në zbatim të nenit 37 *Komisioni i Apelimit*, të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik ne Universitetin e Arteve” Senati Akademik brenda datës 04.02.2022 zgjedh anëtarët e Komisionit të Apelimit.
7. Administratori i UART të vendosë në dispozicion të komisioneve të zgjedhjeve dhe Komisionit të Apelimit ambientet dhe bazën materiale të nevojshme për mbarëvajtjen e të gjithë këtij procesi zgjedhor ne UART.
8. I gjithë dokumentacioni zgjedhor, duke filluar nga ky urdhër dhe deri në përfundim të procesit zgjedhor të ruhet në bazë të rregullave që parashikon kuadri ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri i gjithe personeli akademik, studentët, nëpunësit e administratës dhe autoritetet drejtuese në UART.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot Çausi



**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**